



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 26 shkurt, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e Isni Kilajt kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi paraburgimin, të datës 5 janar. Paneli i Apelit konfirmoi konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se kushtet e propozuara prej Mbrojtjes, përfshirë dorëzaninë, do të ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që z. Kilaj të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit, ose të kryejë krime të tjera.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i 47-të i thirrur nga Prokuroria dha dëshmi të hënën. Personi ishte dëshmitar i mbrojtur, i cili, sipas përmbledhjes së lexuar prej Prokurorisë në sallën e gjyqit, ishte banor i Prizrenit që u mor dhe mbajt i ndaluar prej anëtarëve të UÇK-së në qershor të 1999.

Të mërkurën, dëshmitari i 48-të i thirrur prej Prokurorisë dëshmoi përmes videolidhjes, me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes, edhe ky dëshmitar ishte banor i Prizrenit që u mor dhe mbajt i ndaluar prej anëtarëve të UÇK-së në qershor të 1999.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 27 shkurt, Trupi Gjykues lëshoi vendim lidhur me kërkesën e Rexhep Selimit për rishikim gjyqësor të vendimeve të marra prej Administratores në lidhje me vizitat dhe komunikimet e tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Ndër konstatimet e tjera, Trupi Gjykues përcaktoi se vendimi i Administratores për mbikëqyrjen aktive të disa thirrjeve telefonike ishte pjesë e kompetencave të saj, si dhe i domosdoshëm e proporcional, duke rrëzuar kështu kërkesën e Selimit për prapësim të vendimit. Sidoqoftë, Trupi Gjykues prapësoi vendimin për të mos i lejuar një thirrje telefonike të akuzuarit nga një person specifik dhe urdhëroi Administratoren të mos refuzojë thirrje të tilla, përveç nëse kjo diktohet prej rrethanave të reja.

Sa për kujtesë: më 1 dhjetor, Trupi Gjykues lëshoi një vendim lidhur me modifikimin e kushteve të paraburgimit për tre nga të akuzuarit: Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, pasi konstatoi se duket se tre të akuzuarit u kanë dhënë vizitorëve informacion konfidencial të marrë në kontekstin e procesit gjyqësor, ose të dhënë gjatë dëshmive të dëshmitarëve të mbrojtur.

Në kuadër të këtyre masave, Trupi Gjykues urdhëroi që thirrjet telefonike të këtyre tre të akuzuarve duhet të marrin miratimin paraprak të Administratores dhe gjykatësit udhëzuan Administratoren që, para miratimit të thirrjeve, të sigurojë se bashkëbiseduesi i mundshëm nuk ka kryer sjellje të papajtueshme me integritetin e procesit gjyqësor ose mbrojtjen e informacionit konfidencial.





Në të njëjtin Vendim, Trupi Gjykes po ashtu urdhëroi Administratoren të kryejë mbikëqyrje aktive (për të cilat të akuzuarit duhet të njoftohen) të vizitave dhe komunikimeve me videolidhje dhe me audio, kur Administratorja në ushtrimin e funksionit të vet apo me udhëzim të Trupit Gjykes kur është e nevojshme, konstaton se kjo është e domosdoshme për sigurimin e integritetit të procesit gjyqësor, mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe/ose për garantimin e respektimit të masave të urdhëruara në vendim.

Ndër lajme të tjera: Ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i DHSK-së këtë javë ndodhet në vizitë në Kosovë ku po takohet me studentë të drejtësisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Prishtinë, Mitrovicë dhe Hoçë të Madhe. Që prej 2018, ky ekip është takuar me mbi 3,500 persona në gjithë Kosovën dhe ka dhënë informacione për gjykatën, ka dëgjuar pikëpamjet e njerëzve dhe u është përgjigjur pyetjeve të tyre.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

